



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:161584
Datë: 24.04.2024
Numri i dokumentit: 05612865

A.C.nr.10358/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Bislimaj kryetar, Faton Ademi, dhe Hidajete Gashi Alaj, anëtar, në çështjen kontestimore të paditësit F. J. nga fshati G. U., të cilën e përfaqëson me autorizim Q. R., av. nga Lipjani, kundër të paditurës Byroja Kosovare te Sigurimit me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim B. K., për shkak të kompensim i dëmit material dhe jo material, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Lipjan, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.534/2018 datë 11.10.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 22.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Pjesërisht aprovohet si e themeltë ankesa e të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë, Ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Lipjan, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.534/2018 datë 11.10.2021 në pikën I/a dhe II sa i përket kompensimit të dëmit jo material, NDRYSHOHET, ashtu që gjykohet si në vijim: Aprovohet Pjesërisht si e bazuar kërkesë padia e paditësit F. J. nga fshati G. e U., Komuna e Lipjanit dhe Detyrohet e paditura Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë që paditësit, t'ia kompensoj dëmin jo material dhe atë: Në emër të dhimbjeve fizike të përjetuara, shumën prej 4,500.00 euro. Në emër të frikës së përjetuar shumën prej 4,000.00 euro. Në emër të dhimbjeve shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësorë shumën prej 3,000.00 euro. Ndërsa Pjesa tjetër e kërkesë padisë së paditësit F. J. nga fshati G. e U., Komuna e Lipjanit, përtej shumës së gjykuar për këto kategori të dëmit e deri në shumen e kërkuar, refuzohet si e pa bazuar.

II. Pjesërisht refuzohet ankesa e të paditurës Byroja Kosovare e sigurimeve, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Lipjan, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.534/2018 datë 11.10.2021, në pikën I/b në pjesën aprovuese dhe II/b në pjesën refuzuese, në që ka të bëjë me dëmin material, kamata e gjykuar si dhe pika III. VËRTETOHEN.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin C.nr.534/2018 datë 11.10.2021, ka vendosur: I.PJESËRISHT APROVOHET kërkesëpadia e paditësit F. J. nga fshati G. e U., si e BAZUAR, Obligohet e paditura Byroja Kosovare e Sigurimit me seli ne Prishtine, që paditësit t'ia paguaj në emër të shpërblimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit rrugor, me datë 20.08.2018, shumat si vijon:

I/a. Dëmin jo material

- a) Në emër të dhimbjeve fizike- trupore, shumën prej 6,500.00.-€
- b) Në emër të frikës së përjetuar, shumën prej 5,000.00.-€
- c) Në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej 4,000.00.€

I/b. Dëmin material

- a) Në emër të ushqimit të përforcuar, shumën prej 89.00.€
 - b) Në emër të ndihmës dhe përkujdesjes nga personi i tretë, shumën prej 89.00€
 - c) Në emër të terapisë fizikale dhe shpenzimeve të mjekimit, shumën prej 464.00.-€
- Te gjitha këto shuma me kamate vjetore prej 8%, duke filluar nga dt. 11.10.2021, e deri tek pagesa definitive.

II. Në pjesën tjetër kërkesëpadia e paditësit më tepër se shumat e aprovuara, si në al. I/a, I/b të dispozitivit të këtij aktgjykimi, dhe kërkesëpadia në emër të fitimit të humbur në shume prej 42,700.00.-€ REFUZOHEN si të pa bazuara.

III.OBLIGOHET e paditura, që paditësit t'ia paguaj shumën prej 2,253.20-€. në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, si dhe shumat nga al. I/a, I/b e dispozitivit të këtij aktgjykimi, në afat prej 15 dite nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë e paditura, për shkak të: Shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së shkallës së dytë që ta aprovoj në tërësi si të bazuar ankesën e të paditurës dhe aktgjykimin e atakuar ta prishë dhe lëndën ta kthejë në Gjykatën e shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Paditësi nuk ka parashtruar përgjigje në ankesën, edhe pse i njëjti me kohë e ka pranuar ankesën e të paditurës.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore dhe gjeti se:

- Ankesa e të paditurës, është pjesërisht e themeltë.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësit F. J. nga fshati G. e U., Komuna e Lipjanit, me datë 28.12.2018, në gjykatën e shkallë së parë, ka paraqitur padi ndaj të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë, për kompensimin e dëmit material dhe jo material si dhe shpenzimet e procedurës, të cilën kërkesë e ka precizuar me parashtrësën e dorëzuar me datë 30.06.2021, me kërkesë si në parashtrësën e dorëzuar me shkrim.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, dëgjimit të palëve ndërgjyqëse si dhe administrimit të provave, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar C.nr. 534/2018, të datës 11.10.2021, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesë padinë e paditësit, duke vendosur me saktësisht si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimin të atakuar ndër të tjera ka arsyetuar se: Ne mes palëve ndërgjyqësore nuk ishte kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë, përkatësisht se me lëshimet ekskluzive të ngasësit D. R. veturës VW Pasat me targa të regjistrimit KRSV954, është shkaktuar aksidenti në komunikacionin rrugor, ashtu që i njëjti me automjetin e tij ndërmerr veprim për ndërrimin e shiritit në mënyrë të pasigurve dhe pa u bindur se pengon pjesëmarrësit tjerë në komunikacion, me që raste me pjesën e djathtë të përparmë të veturës e godet veturën VW Golf, me targa të regjistrimit ...-3...-GF të cilën e ngiste paditësi, me ç' raste të njëjtit i shkaktonte dëmtime të renda trupore në cilësi të ngasësit të automjetit, e i cili automjet i ngasësit D. R., nuk ka pas sigurim valid nga auto përgjegjësia tek ndonjë kompani sigurimi të licencuar në Kosovë, e mbi këtë baze e paditura, e konform nenit 136, nenit 154 dhe 159 të LMD-së, (Gazeta Zyrtare e RKS-së Ligji nr.04/L-077) dhe n.18 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopergjegjsia, është përgjegjëse për shpërblimin e dëmit paditësit, për të gjitha format e tij.

Më tej ka arsyetuar se: Nga mendimi dhe konstatimi i ekspertit gjyqësor Dr. F. Q. neurokirurg të dhënë në seancën për shqyrtim kryesor të dt.11.10.2021, në baze të raporteve të QKUK-se, Qendrës Emergjente dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit, mendim dhe konstatim këtë të cilit gjykata ua fali besimin në tërësi, nga se nuk pat prova tjera me të cilat do të vihej në dyshim ky mendim dhe konstatim, vërtetohet se paditësi, ka pësuar lëndime trupore kontuzione në regjionin lumbal (ndrydhje në regjionin Lumbal) instabilitet të unazës L3, L4 (jo stabilitet i unazave lumbale në L3, L4), lëndime këto të cilat kualifikohet si lëndime të natyrës së renda trupore me pasoja.

Më tej ka arsyetuar se: Në emër të dhimbjeve fizike, i është caktuar shuma prej 6,500.00€, duke pasur parasysh mendimin dhe konstatimin e ekspertit gjyqësor Dr. F. Q., se i njëjti ka përjetuar dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të renda në kohëzgjatje prej 30 minutave, deri në dhënien e ndihmës përkatëse mjekësore, dhimbje të intensitetit të renda ka pësuar në kohëzgjatje

prej 5 ditëve, deri ne marrjen e terapisë për shkak se dhimbjet e mesit janë dhimbje te renda ku nevojitet terapi gjate ter ditës, dhimbje te intensitetit te mesëm ka pas ne kohëzgjatje prej 30 ditësh, dhe dhimbje te intensitetit te ulëte ka kohe pas kohe, ndërsa Në emër të frikës së përjetuar paditësit i është caktuar shuma prej 5,000.00.€, duke pasur parasysh mendimin dhe konstatimin e ekspertes gjyqësore Dr. S. B., psikiatër, sipas se cilës paditësi ka përjetuar frike primare te intensitetit te larte te manifestimit, qe ka zgjatur për disa sekonda, frike sekondare te intensitetit te larte e cila ka zgjate për 24 ore, e shoqëruar me ankthe, shqetësim, frike nga rivaliteti i përhershëm, rikujtim i ngjarjes traumatike dhe simptomat tjera përcjellëse te reagimit akut ndaj stresit, frike sekondare te intensitetit te mesëm qe ka zgjatur për dy muaj, frike sekondare te intensitetit te ulte qe ka zgjate edhe për tre muaj. -Ne emër te zvogëlimit te aktivitetit te përgjithshëm jetësor, paditësit i është caktuar shuma prej 4,000.00.-€, duke u bazuar ne mendimin e eksperteve gjyqësor te neurokirurgjisë Dr. N. H. dhe dr. F. Q., sipas te cilëve paditësi si pasojë e lëndimeve te marrura ne këtë aksident te komunikacionit rrugor, ka zvogëlim te aktivitetit te përgjithshëm jetësor ne shkalle prej 5%, si pasojë e in stabilitetit te unazës L3 dhe L4. - Ne emër te ushqimit te përforcuar gjykata i ka caktuar paditëses shumën prej 98.00€, duke pasur parasysh mendimin e eksperteve gjyqësor neurokirurgjisë Dr. N. H. dhe dr. F. Q., se ushqimi i përforcuar për paditësen ka qene i nevojshëm për 14 dite, si ushqim i pasur me minerale, vitamina dhe proteina, si dhe duke pasur parasysh dispozitën e nenit 27 te Rregullores për përcaktimin e kriterëve për vlerësimin e dëmeve jo materiale nga auto përgjegjësia e miratuar nga Banka Qendrore e Kosovës me dt. 31.08.2016 ku shpërblimi mujor për ushqimin e përforcuar pranohet deri ne lartësinë prej 210.00.€ përkatësisht 7 € për një dite. -Ne emër te ndihmës se personit te trete paditësit i është caktuar shuma prej 98,00.-€, duke pasur parasysh mendimin e eksperteve gjyqësore neurokirurgjisë Dr. N. H. dhe Dr. F. Q., sipas se cilëve kjo ndihme i është nevojitur paditësit për kryerjen e obligimeve te përditshme mjekësore e gjate se cilës periode i është rekomanduar edhe mbajtje e një korseti Lubosakral LS.

Më tej ka arsyetuar se: Ne emër të terapisë fizikale dhe shpenzimeve te shërimit, paditësit i është aprovuar kërkesëpadia në shume prej 464.00.-€, bazuar ne faturat dhe kuponat fiskal te cilët gjenden ne shkresat e lendes e të cilat janë administruar në këtë çështje kontestimore, nga të cilët është vërtetuar shuma e cekur më lartë.

Më tej ka arsyetuar se: Gjykata, konsideron shumat e aprovuara për demin jo material paraqesin një satisfaksion ekuivalent me intensitetin e dhimbjes fizike, frikës se përjetuar dhe kohëzgjatjen e tyre, shkalles se zvogëlimit te aktivitetit te përgjithshëm jetësor, ndërsa sa i përket demit material, shumat e aprovuara janë ekuivalent me demin e shkaktuar ndaj paditësit, ne këtë aksident te komunikacionit rrugor.

Gjykata në lidhje me kamatën e gjykuar ka vendosur në kuptim të nenit 382.2 të LMD-së.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë në kuptim të nenit bazë të neneve 452par. 1 dhe 5 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i Gjykatës së shkallës së parë është pjesërisht i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që Aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, drejtë dhe në mënyrë të plotë është vërtetuar gjendja faktike, mirëpo e drejta materiale pjesërisht është zbatuar në mënyrë të gabuar. Gjithashtu aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se Aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika n) lidhur me nenin 160 par. 4 e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i Aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë dhe i ekzekutueshëm, e në përputhje të plotë me arsyet e Aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike i dispozitivit me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadsisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Po ashtu Gjykata e Apelit i vlerëson si të pa qëndrueshme pretendimet ankimore të paditurës për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. E paditura tani me ankesë vetëm e përmend si bazë ankimore vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike a në fakt ajo më shumë aktgjykimin e atakon për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale lidhur me lartësinë e shumave të gjykuara. Baza juridike e kërkesëpadsisë së paditësit nuk ka qenë kontestuese në mesë palëve ndërgjyqëse në kuptim të shkaktimit të aksidenti si dhe të drejtës për kompensimin e dëmit, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se e paditura vazhdimisht ka dhënë ofertë për zgjidhjen e çështjes me pajtim gjyqësorë, ndërsa faktet rreth lartësisë së kërkesëpadsisë janë konstatuar nga ekspertizat mjekësore të cilave ekspertiza gjykata e shkallës së parë, por edhe kjo e Apelit ja fali besimin e plotë pasi që të njëjtat janë të përpiluara në baza ligjore dhe shumë profesionale.

Mirëpo, Gjykata e Apelit konstaton se gjykata e shkallës së pjesërisht në mënyrë të gabuar ka aplikuar të drejtën materiale kur janë gjykuar shumat për demin jo material ne emër të dhimbjen fizike trupore, për friken e përjetuar, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësorë. Gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar dispozitën e nenit 183 të LMD-së. Pasi që shumat janë të larta dhe nuk u shkojnë përshtati synimeve dhe qëllimeve shoqërore për kompensimin e dëmit dhe as nuk janë në pajtueshmëri as me praktikën gjyqësore, prandaj gjykata e shkallës së dytë e aprovoi pjesërisht ankesën e të paditurës ndryshoi aktgjykimin pjesërisht dhe gjykoi si në dispozitiv nën I. të këtij aktgjykimi duke vlerësuar se shumat e aprovuara nga gjykata e shkallës së parë për format e kompensimit të dëmit jo material nuk bazohen në kriteret e zbatueshme për vlerësim, e as në praktikën gjyqësore të krijuar nga gjykatat e Kosovës, për këto forma të shpërblimit të demit dhe as në natyrën dhe llojin e së mirës së dëmtuar.

Gjykata e Apelit, vlerëson se shumata e gjykuara si në dispozitivin e këtij aktgjykimit janë adekuate me kriteret dhe qëllimin e përcaktuar me nenin 183 të LMD, këto shuma përfaqësojnë një satisfaksion adekuat që i dëmtuari t'i përballojë më lehtë dëmet jo materiale të pësuar, edhe pse këto forma të dëmit nuk mund të vlerësohen e as të kompensohen me para. Me paragrafin 2 të nenit 183 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve përcaktohet se me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jo material, si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky kompensim, e gjithashtu edhe për faktin se të mos u shkojë përshtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror". Pra, nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore rezulton se kompensimi duhet të jetë adekuat me natyrën e lëndimit, intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhembjeve të përjetuara, frikës së të dëmtuarit dhe zvogëlimit të aktivitetit jetësor i cili ka qenë i shprehur në lartësinë prej 5 %, të konstatuara nga ekspertët mjeko ligjor Dr. F. Q. Neurokirurg, Dr. N. H. Neurokirurg si dhe Dr. dr. S. B. Psikiatër, ashtu që kompensimi të përfaqësojë një lehtësim në përballimin e tejkalimit të pasojave të dëmit, të pësuar në aksidentin e komunikacionit, shumata e gjykuara nga gjykata e shkallës së dytë si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi janë reale dhe paraqesin satisfaksion të vërtet dhe u shkojnë për shtati synimeve shoqërore për kompensimin e dëmit. Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes mori parasysh të gjitha rrethanat moshën e paditësit, shkallën e zvogëlimit të aktivitetit jetësor, kohëzgjatjen e dhimbjeve fizike, kohëzgjatjen e frikës, praktikën gjyqësore të krijuar gjerë më tani sa i përket shpërblimit të dëmit për këto kategori.

Gjykata e Apelit, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejt ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, kur ka vendosur në lidhje me kompensimin e dëmit material, ndihmën dhe kujdesin e huaj si dhe ushqimin e përforcuar. Gjykata e Apelit vlerëson se shumata e gjykuara nga gjykata e shkallës së parë në lidhje me kompensimin e dëmit për ushqim të përforcuar si dhe ndihmën e personit të tret, janë adekuate dhe i përshtaten natyrës së lëndimeve si dhe kohëzgjatjes së rehabilitimit të të dëmtuarit. Fakti që për këtë kategori të dëmit nuk është ofruar prova materiale, gjykata e Apelit vlerëson se edhe për kundër mos ofrimit të provave për këtë kategori të dëmit, dëmi është shkaktuar dhe se paditësit është fakt i pa kontestueshëm se të njëjtit i janë nevojitur ushqim i përforcuar dhe ndihma e personit të tretë pasi që një gjë e tillë janë konstatuar edhe në ekspertizën e cekur si më lartë.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë kur ka gjykuar dëmin material për shpenzimet e shërimit si dhe shpenzimet e terapisë fizikale, pasi që e njëjta lartësinë e dëmit material është vërtetuar me prova materiale të cilat janë administruar në këtë çështje kontestimore dhe të cilave i është fal besimi i plotë, pasi që të njëjtat janë në përputhje të plot edhe me natyrën e lëndimeve të konstatuara në ekspertizën e ekspertëve mjeko ligjorë, por edhe me nevojën e paditësit për të ardhëri tek rehabilitimi dëmtimeve të pësuar në aksidentin e trafikut të cekur si më lart.

Gjykata e Apelit i vlerësoj pretendimet e të paditurës në lidhje me kundërshtimin e bazës juridike në kuptim të shkaktimit të aksidenti por edhe të përgjegjësisë objektive të të paditurës, por të njëjtat pretendime nuk i morri për bazë, pasi që nga shkresat e lëndës vërtetohet se e paditura asnjëherë nuk e ka kundërshtuar bazën juridike të kërkesë padisë, por e njëjta e ka kundërshtuar lartësinë e kërkesës, andaj në këtë kuptim e paditura në këtë fazë të procedurës nuk mund të kundërshtojë bazën juridike pasi që gjykata e shkallës së parë duke u nisur nga deklaratimet e të paditurës për mos kundërshtimit të bazës juridike nuk ka administruar prova materiale për të vërtetuar bazën sepse e njëjta është bërë fakt jo kontestues. Ndërsa sa i përket pretendimeve për përgjegjësi objektive, gjykata e Apelit këto pretendime nuk i mori për bazë, pasi që në rastin konkret baza juridike e paditësit lidhet me Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopergjegjësia dhe se nuk bëhet fjalë për shkaktimin e dëmit nga sendi i rrezikshëm dhe një gjë të tillë e paditura në asnjë fazë të procedurës nuk e ka potencuar një kundërshtim të tillë.

Sa i përket vendimit për kamatën e gjykuar nga gjykata e shkallë së parë, edhe gjykata e Apelit e përkrah një vendim të tillë pasi që kamata e gjykuar është në pajtueshmëri të plotë me nenin 382 të LMD-së.

Sa i përket vendimit për shpenzimet procedurale të gjykuara nga gjykata e shkallë së parë, edhe gjykata e Apelit e përkrah një vendim të tillë pasi që shpenzimet e aprovuara janë shpenzime në përputhshmëri të plotë me veprimet procedurale, e gjithashtu duke pas parasysh edhe suksesin e paditësve në procedurë dhe atë në kuptim të nenit 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit i ka vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por gjeti se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga të cekurat u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në bazë të nenit 195.1 pika d) dhe e), të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
A.C.nr.10358/2021 datë 22.04.2024

Kryetari i kolegjit - gjyqtari,
Besnik Bislimaj, d.v